

Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21) dhe neni 35, paragrafi 1) të Ligjit të Punës me Deviza (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13, 97/15, 153/15 dhe 23/16 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

## **VENDIM**

### **Për ndryshimin e Vendimit për mënyrën e formimit dhe të publikimit të kurseve të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë**

1. Në titullin e Vendimit për mënyrën e formimit dhe të publikimit të kurseve të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 58/14, 102/14 dhe 14/15) dhe në pikën 1), fjalët: "Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut".

2. Në pikën 3) neni 1 dhe 4, fjalët: "ora 16" zëvendësohen me fjalët: "ora 16:00".

Në pikën 4), fjala: "BPRM" zëvendësohet me fjalët: "Banka Popullore".

3. Pika 4) ndryshon dhe bëhet:

"Normat mesatare për monedhat tjera në listën e kursit të këmbimit llogariten bazuar në normat e referencës ditore të euros dhe valutave tjera, të publikuara nga Banka Qëndrore Europiane.

Në ditë jopune, për sistemin e pagesave në eurozonë TARGET2, kur Banka Qëndrore Europiane nuk ka publikuar normat e referencës ditore të këmbimit, kurset mesatare të këmbimit për valutat tjera llogariten në bazë të kurseve të tregut të publikuara në sistemet financiare elektronike për tregjet financiare ndërkombëtare.

Në kushte kur Banka Qëndrore Europiane nuk publikon kurs ditor të referencës për një valutë të caktuar, e cila është pjesë përbërëse e Listës së Kurseve të Bankës Popullore, Banka Popullore llogarit kursin mesatar të këmbimit për atë monedhë, bazuar në kurset e këmbimit të tregut të publikuara në sistemet financiare elektronike për tregjet financiare ndërkombëtare".

4. Në pikën 6), fjalët: "ora 17:00" zëvendësohen me fjalët: "ora 18:00".

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

**V nr. 02-15/V-9/2022**  
**31 mars 2022**  
**Shkup**

**Guvernatore**  
**dhe kryetare**  
**e këshillit të Bankës Popullore**  
**të Republikës së Maqedonisë së Veriut**  
**dr. Anita Angellovska-Bezhoska**